



QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

1 KORRIK 2025 / PËRKUJTIMORE NË 1-VJETORIN E NDARJES NGA JETA TË SHKRIMTARIT TË MADH, ISMAIL KADARE



31 KORRIK 2025 / “ÇMIMI PASHKO GJEÇI PËR PËRKTHIMIN LETRAR ITALIAN”



18 KORRIK 2025 / NË PËRKUJTIM TË PIER PAOLO PASOLINIT - FIGURË SHUMËDIMENSIONALE E KULTURËS ITALIANE



5 korrik 2025 / Takim letrar me temë “Letërsia dhe kufijtë” – Në Peshkopi



16 korrik 2025 / Një takim me fëmijët e “Cody after school”



19 korrik 2025 / U përkthye në maqedonisht “Një udhëtim e gjysmë”, libri me poezi i Manjola Nasit



25 korrik 2025 / Takim me autorin nga Kosova, Lulëzim Tafa



30 korrik 2025 / Shkrimtarja shqiptare Ledia Xhoga - pretendente për Çmimin e madh të letërsisë, Booker Prize 2025





QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

1 KORRIK 2025 / PËRKUJTIMORE NË 1-VJETORIN E NDARJES NGA JETA TË SHKRIMTARIT TË MADH, ISMAIL KADARE



KADARE

U mbush një vit nga ndarja nga jeta e shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare. Në këtë ditë kujtese nderojmë me respekt figurën e tij dhe veprën që ai la pas – një trashëgimi që vazhdon të frymëzojë breza të tërë.

Kadare ishte një zë i fuqishëm në letërsinë shqipe dhe përtej saj. Ai solli në faqet e librave historinë dhe kujtesën kolektive të shqiptarëve, duke i dhënë zë fjalës së thjeshtë, dhimbjes, shpresës dhe dinjitetit njerëzor.

Veprat e tij si “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Prilli i thyer”, apo “Kronikë në gur” janë jo vetëm pasqyrë e një kohe të vështirë, por edhe rrëfim i ndjeshëm për jetën dhe njeriun shqiptar. Me gjuhë të kujdesshme, me ndërtim të hollë letrar dhe me një vështrim që kapte thellësitë e njerëzore, Kadare arriti të bëhet një nga zërat

më të njohur të letërsisë evropiane.

Sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë të rikthehemi te libri, te fjala, te letërsia që na ndihmon të kuptojmë veten dhe botën. Dhe pak autorë e bëjnë këtë më mirë se Kadare.

Në një kohë kur letërsia konsiderohej si vegël e strategjisë politike dhe çdo përpjekje për të hyrë në territore shpirtërore apo filozofikeurvejohej, Ismail Kadare krijoi një letërsi që nuk pranoi të mbyllej brenda kufijve ideologjikë. Përmes historisë, mitit, simbolikës dhe qëndrimit estetik, ai arriti të trajtojë tema që lidhen me transcendencën e njeriut – përballjen me pushtetin, vdekjen, fatin dhe shpirtin. Vepra e tij është dëshmi se arti i vërtetë, edhe në kushte shtypjeje, mund të

ngrihet mbi kohën, mbi frikën, mbi censurën. Historia dhe miti si urë drejt të përjetshmes.

Kadare e kuptoi se tema e përjetshme nuk mund të paraqitej drejtpërdrejt në një regjim që ndalonte metafizikën. Prandaj, ai përdori historinë dhe mitin për të shpëtuar idetë me mënyrën me të zgjuar.

Në “Kush e solli Doruntinën”, ai ringjall një legjendë shqiptare, ku vëllai i vdekur vjen për të mbajtur një premtim – një përballje mes jetës dhe vdekjes, ndërmjet nderit dhe te mbinatyrshmes. Kjo histori është e mbushur me simbolikë të shpirtit, të betimit të shenjtë, që realizon përtej kufijve të logjikës dhe vdekjes.

Po ashtu, te “Ura me tri harqe”, ndërtimi i mëdha mitike shoqërohen me sakrificat njerëzore, që evokojnë përplasjen



QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

mes përparimit dhe vetëmohimit
njerëzor – një reflektim universal
për çmimin e qytetërimit.

Kadare nuk është vetëm një
shkrimtar i një vendi të vogël
ballkanik, por një zë universal që

arrin të prekë të përjetshmen –
thelbin e vetë artit letrar.

Përulemi me respekt para kujtimit
të tij dhe e falënderojmë për

gjithçka që i dha gjuhës, kulturës
dhe shpirtit shqiptar.

31 KORRIK 2025 / “ÇMIMI PASHKO GJEÇI PËR PËRKTHIMIN LETRAR ITALIAN”

Qendra Kombëtare e Librit dhe
Leximit në bashkëpunim me
Institutin Italian të Kulturës (IIC)
në Tiranë, njoftuan “Çmimin
Pashko Gjeçi për përkthimin
letrar italian” – një iniciativë e re
kushtuar promovimit të letërsisë
italiane në shqip dhe nderimit të
rolit jetësor të përkthyesve
letrarë në Shqipëri dhe Kosovë.

Ky projekt i përbashkët synon të
ftojë të gjithë përkthyesit
shqiptarë të italishtes për të
aplikuar me dorëshkrimet e
veprave bashkë-kohore italiane

të përkthyer në gjuhën shqipe,
dhe veprat fituese do të
mbështeten për botim nga QKLL,
ndërsa IIC Tirana do të
mbështesë punën përkthimore.

Ky çmim vjen në nder të Pashko
Gjeçit, përkthyesit dhe
intelektualit të njohur shqiptar
që përfundoi përkthimin e parë
të plotë në shqip të Komedisë
Hyjnore të Dante Alighierit.
Çmimi manifeston lidhjen e
qëndrueshme midis kulturës
letrare italiane dhe asaj shqipe.
Vepra monumentale e Gjeçit

mbetet një moment historik në
letrat shqipe dhe një simbol i
dialogut gjuhësor dhe kulturor.

Nga “Çmimi Pashko Gjeçi për
përkthimin letrar italian” do të
dalin dy vepra fituese të
përkthyer nga përkthyes me
kombësi shqiptare, vepra të cilat
nuk janë botuar ende në gjuhën
shqipe.

Fituesit do të shpallen në muajin
tetor përgjatë Javës së Kulturës
Italiane.





QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

5 KORRIK 2025 / TAKIM LETRAR ME TEMË “LETËRSIA DHE KUFIJTË” – NË BIBLIOTEKËN E PESHKOPISË

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Bibliotekën e qytetit të Peshkopisë, organizoi në ambientet e kësaj biblioteke, takimin letrar me temë “Letërsia

dhe kufijtë” me praninë e shkrimtarëve Flutura Ačka dhe Ylljet Aliçka. Të pranishmit i përshëndeti dhe kryetari i bashkisë së Peshkopisë, Z. Rrahim Spahiu.

Ky takim është pjesë e ciklit që QKLL-ja ka ndërmarrë në qytete të ndryshme të Shqipërisë përgjatë muajit qershor i cili vazhdoi edhe në korrik.



16 KORRIK 2025 / NJË TAKIM ME FËMIJËT E "CODDY AFTER SCHOOL"



U mbajt në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit një takim emocionues me fëmijët e "Cuddy After School". Pjesë e këtij takimi ishte e pranishme autorja e letërsisë për fëmijë, Valbona Banka.

e cila u foli fëmijëve për magjinë e leximit. Letërsia për fëmijë është pjesë e rëndësishme e politikave tona, pasi leximi është çelësi për një brez më të edukuar në të ardhmen.



QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

18 KORRIK 2025 / NË PËRKUJTIM TË PIER PAOLO PASOLINIT - FIGURË SHUMËDIMENSIONALE E KULTURËS ITALIANE

Në kuadër të 50-vjetorit të vdekjes së Pier Paolo Pasolinit, një figurë shumëdimensionale e kulturës italiane, poet, shkrimtar, regjisor, skenarist, dramaturg dhe gazetar, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi aktivitetin me temë "Pasolini, arti dhe

pushteti" ku u diskutua mbi kontributin e tij në artin e letërsisë.

Përgjatë aktivitetit pati diskutime dhe lexime, interpretime nga krijimtaria poetike e Pasolinit.


Aktiviteti shënjoji edhe çeljen e "Varg Festival" 2025 dhe u mbajt në mjediset e Torrës Veneciane, Durrës.



19 KORRIK 2025 / MBËSHTETJA E LIBRIT SHQIP NË GJUHË TË TJERA - U PËRKTHYE NË MAQEDONISHT "NJË UDHËTIM E GJYSMË", LIBRI ME POEZI I MANJOLA NASIT

"Një udhëtim e gjysmë", libri me poezi i Manjola Nasit u përkthye në maqedonisht nga Monika Mitreva, me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Librit dhe

Leximit. Autorja ishte e pranishme për lexuesin në një aktivitet organizuar më 19 korrik, në Ohër. Mbështetja e librit shqip në gjuhë të tjera, një prioritet i punës sonë





QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT


25 KORRIK 2025 / TAKIM ME AUTORIN NGA KOSOVA, LULËZIM TAFI

U promovua në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit përmbledhja poetike "Antologji personale" e autorit nga Kosova, Lulëzim Tafi. Një përmbledhje poetike interesante ku gërshetohen poezitë me natyrë patriotike me ato metafizike. Të

pranishëm në panel ishin: prof. dr. Sali Bashota, prof.dr. Shaban Sinani, poetesha Mimoza Ahmeti, të cilët shprehën gjykimet e tyre mbi përmbledhjen poetike. Pjesë e këtij takimi ishin edhe emra të tjerë të rëndësishëm të kulturës shqiptare, si:

akad. Vaso Tole, akad. Anastas Angjeli, Aleksandër Çipa, ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipëri, z. Skënder Durmishi etj.

Takimi u mbajt në mjediset e ish - Ministrisë së Kulturës, Kinostudio.





QKLL 2025

KORRIK



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

30 KORRIK 2025 / SHKRIMTARJA SHQIPTARE LEDIA XHOGA - PRETENDENTE PËR ÇMIMIN E MADH TË LETËRSISË, BOOKER PRIZE 2025

Shkrimtarja shqiptare Ledia Xhoga është bërë pjesë e listës së gjatë të pretendentëve për Çmimin e madh të letërsisë, Booker Prize 2025 me romanin e saj “Misinterpretation”.

Ledia Xhoga është shkrimtarja shqiptare e dytë që nominohet për Booker Prize pas Ismail Kadaresë që e ka fituar çmimin, në vitin e themelimit të tij në 2005, dhe është nominuar po ashtu edhe dy

herë të tjera në 2017-n dhe në 2024-n.

Fituesi i këtij viti për Booker Prize do të njoftohet më datë 10 nëntor 2025.

